

FTESË PËR OFERT

Emri: Milieukontakt Shqipëri
Adresa: Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion,
Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri
E-mail: office@milieukontakt.org
Afati i dorëzimit të ofertës: 8/6/2026

Milieukontakt Shqipëri po zbaton projektin “**Mjedisi në sytë e të rinjve (N’Sÿ)**”, mbështetur nga **Bashkia e Tiranës**. Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, organizata kërkon të realizojë procedurën e thjeshtë të prokurimit për: “**Blerje e 2 Pajisjeve Tablet Elektronik**”

Kushtet për pjesëmarrje

Të gjithë subjektet apo personat fizikë të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre, sipas kushteve të përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese, në adresën e e-mailit:

office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në adresën:

Rr. “Xhorxhi Martini”, Pall. Teuta Konstruksion, Shk. 3, Ap. 8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri.

Ofertat duhet të përmbajnë çmimin për njësi, specifikimet teknike të produktit, afatin e dorëzimit dhe kushtet e garancisë.

Specifikimet teknike

2 Tabletat duhet të kenë minimumi specifikat si me poshtë:

- Ekran: LCD
- Memorje RAM: 2 giga
- Lidhje Wi-Fi
- Kamera kryesore: 8 MP
- Bluetooth
- Bateri e përshtatshme për përdorim disaorësh;
- Karikues i përfshirë në paketim;
- Garanci për pajisjen.

Ofertuesi mund të përfshijë në ofertë edhe aksesore shtesë, si mbrojtëse ekrani ose këllëf mbrojtës, në rast se këto janë pjesë e paketës së ofruar.

Ofertuesi duhet të garantojë se:

- Produktet janë në gjendje të plotë funksionale;
- Çmimi përfshin të gjitha kostot përkatëse, përfshirë TVSH-në, transportin dhe dorëzimin;
- Produktet dorëzohen brenda afatit të përcaktuar nga organizata;
- Pajisjet shoqërohen me faturë tatimore dhe dokumentacion garancie.

Kushte të përgjithshme

Ofertuesi duhet:

- Të jetë i regjistruar si subjekt tregtar sipas legjislacionit në fuqi;
- Të ketë status aktiv dhe NIPT të vlefshëm;
- Të mos jetë në proces falimentimi apo likuidimi;
- Të ketë eksperiencë në furnizimin me pajisje elektronike ose teknologjike;
- Të jetë në gjendje të lëshojë faturë të rregullt tatimore.
- Pagesa do të kryhet me transfertë bankare pas dorëzimit të produkteve, verifikimit të përputhshmërisë me specifikimet e kërkuara dhe dorëzimit të faturës përkatëse.

Nr	Shërbimi	Cope/tableta	Çmimi/njësi Lekë/pa TVSH	Totali/lek/pa TVSH
1	Pajisje Tablet Elektronik (në përputhje me specifikimet teknike më sipër)	2		
	TVSH	20%		
	Total			

Të gjithë subjektet apo personat fizik të interesuar duhet të dorëzojnë ofertën e tyre sikurse parashikohet në kushtet e përgjithshme dhe specifike të kësaj ftese deri më **8 Qershor 2026**, në adresën e e-mailit: office@milieukontakt.org ose nëpërmjet postës në Adresën Rr. ‘Xhorxhi Martini’, Pall. Teuta Konstruksion, Shk.3, Ap.8, Kodi Postar 1017, Tiranë, Shqipëri. Ofertat e dorëzuara dorazi nuk do të merren në konsideratë.

Pagesa e subjektit/personit fizik do të kryhet me transfertë bankare pas përfundimit të shërbimit dhe lëshimit të faturës përkatëse, ose si subjekt i tatimit mbi të ardhurat (15%) sipas legjislacionit shqiptar.

Në ofertën e tij, ofertuesi duhet të paraqesë të dhënat e plota të personit te kontaktit. Krahas ofertës financiare të plotësuar sipas tabelës në ftesë (në Lekë), duhet të paraqesin edhe këto dokumenta:

1. Ofertë financiare (sipas tabelës)
2. Ekstrakt i QKB / ID (nëse është person fizik)

Operatori që ofron shërbimin me çmimin më të ulët dhe në përputhje me specifikimet teknike sipas ftesës, do të njoftohet për të nënshkruar kontratën.

AUTORITETIT KONTRAKTOR
Milieukontakt Shqipëri